



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË ERI SEE**

Nisma e Evropës Juglindore për Reformën në Arsim (Education Reform Initiative of South Eastern Europe ERI SEE) është një platformë rajonale për bashkëpunim të ngushtë në fushën e arsimit dhe trajnimit. Në këtë nismë marrin pjesë Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia, Moldavia, dhe Serbia.

Në përshtatje me zhvillimet e shpejta globale, kjo platformë mbështet reformat kombëtare në arsim dhe trajnim, përmes aftësimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të institucioneve hartuese të politikave arsimore, përshtatjes së njohurive sipas kërkesave të tregut të punës dhe bashkërendimin e tyre me kuadrin evropian për zhvillimin e arsimit.

**Aktualisht, Sekretariati i ERI SEE-së ka shpallur thirrjen për aplikim për pozicionin e Drejtorit të ERI SEE.**

**Vendndodhja:**

Mbajtësi i pozicionit do të vendoset në Sekretariatit e ERI SEE-së në Beograd.

Ky pozicion emërohet nga Bordi Drejtues për një afat prej të paktën tre vitesh.

**Dokumentet për Aplikim:**

- CV (Europass format)
- Kopje të skanuara të diplomave të arsimit të lartë (të përkthyer në gjuhën angleze nga përkthyes të certifikuar).
- Kopje e skanuar e pasaportës
- Letër motivimi
- Dy letra rekomandimi

**Aplikimet mund të dorëzohen vetëm me e-mail në adresën [jobs@erisee.org](mailto:jobs@erisee.org) jo më vonë se 2 dhjetor 2015 nga ora 17:00 .**

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Intervistat do të zhvillohen me kandidatët e përzgjedhur nga komisioni përzgjedhës **në periudhën 20 dhjetor 2015 - 20 janar 2016.**

Për më shumë informacion lutem referojuni adresave si më poshtë:

<http://www.erisee.org/node/321>

[http://www.erisee.org/downloads/2015/VACANCY\\_ANNOUNCEMENT\\_ERI\\_SEE\\_Director.pdf](http://www.erisee.org/downloads/2015/VACANCY_ANNOUNCEMENT_ERI_SEE_Director.pdf)

**DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE**